

Data: 27.07.2023

Për shprehje të interesit për të ofruar përkrahje për kërkesat e bazuara për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore familjare ne zonat rurale, iniciativat për themelimin e bizneseve të reja inovative si dhe modernizimin teknologjik të prodhimtarisë ose zgjerimin e veprimtarisë të bizneseve ekzistuese në Komunën e Hanit të Elezit.

Linjat programore të përkrahjes:

1. Për themelimin e bizneseve të reja ne prodhimtarinë bujqësore familjare ose zgjerimin e atyre ekzistuese,
2. Për iniciativat e themelimit të bizneseve të reja inovative në çdo veprimtari me potencial për zhvillim
3. Për modernizimin ose zgjerimin e kapaciteteve operative prodhuese/shërbyese të bizneseve ekzistuese, të cilët operojnë me sukses së paku dy vite dhe kanë të themeluar biznes apo njësi në Hanin e Elezit.

Kushtet:

Linja programore 1: ju dedikohet të gjithë fermerëve ne zonat rurale që kanë vendbanim dhe pronë në Komunën e Hanit të Elezit. Programi përkrah kërkesat për investime në furnizimin e paisjeve, fidaneve dhe gjërave tjera të domosdoshme për themelimin e bizneseve të reja familjare ose zgjerimin e atyre ekzistuese në bashkëfinancim **70% LAB**, ndersa **30% përfituesi/ja**.

Brenda kësaj linje programore, për anëtarët e shoqatës së bletarëve është paraparë një fond (buxhet) i veçantë për furnizim të koshereve të tipit LR, me dyshe antibakteriale dhe funde për grumbullimin e polenit në vlerë maksimale deri në 5,000 €.

Linja programore 2: ju është dedikuar kërkesave individuale për themelimin e bizneseve të reja inovative. Me fondet ne dispozicion për këtë linjë programore, LAB synon të bashkëfinancoj propozimet inovative për furnizim dhe instalim të pajisje të reja për prodhimtari, ose furnizime tjera të nevojshme për themelimin e biznesit në bashkëfinancim **50:50%** deri në vlerën maksimale prej **30,000€**. Vlera e bashkëfinancimit prej **15,000€** dhe diferenca eventuale mbi vlerën totale sigurohen nga aplikanti dhe mjetet do të derdhen në llogarinë bankare të LAB-it, në emër të bashkëfinancimit pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me përfituesin e përzgjedhur, ndërsa

Linja programore 3: është përcaktuar për kërkesat e sektorit privat për zgjerim të veprimtarisë ose modernizim të kapaciteteve operative të bizneseve ekzistuese të cilët janë të regjistruar dhe operojnë me sukses për të paktën dy vitet e fundit në Komunën e Hanit të Elezit.

Me fondet ne dispozicion, LAB synon të përkrah kërkesat për bashkëfinancim, për furnizim të paisjeve teknike prodhuese për rritjen e kapaciteteve ekzistuese ose për zgjerim të veprimtarisë, duke themeluar biznes të ri prodhues ose për ofrimin e shërbimeve të reja inovative që siguron minimum deri në 3 vende të reja pune. Vlera maksimale investive e pranueshme është deri në **30,000€**, 50% të mbështetjes sigurohet nga Programi LAB, ndersa 50% dhe diferenca eventuale mbi vlerën totale duhet të sigurohen nga përfituesi i përzgjedhur dhe pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mjetet do të derdhen në llogarinë bankare të LAB-it, në emër të bashkëfinancimit.

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjithë fermeret privat, individët me vendbanim në Han të Elezit dhe subjektet biznesore që zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit.

Vlerësimi dhe aprovimi i kërkesave për përkrahje do të zbatohet në përputhje me planin vjetor dhe buxhetin e aprovuar për vitin 2023 dhe në përputhje me kërkesat e donatorit të grantit Sharrcem- Komiteti i CSR-it, ligjet e aplikueshme për OJQ dhe rregullat interne të Organizatës LAB.

Si të aplikohet?

Format e aplikimit për **linjën programore 1** mund të merren drejtpërdrejt nëpërmjet zyres së LAB-it, ndërsa të interesuarit për investime në **linjat programore 2 dhe 3** (për nismat inovative individuale për themelimin e bizneseve të reja dhe për bizneset ekzistuese që synim kanë modernizimin ose rritjen e kapaciteteve operative ekzistuese) format për aplikim mund të shkarkojnë nga web faqja www.lab-ks.org ose të marrin ato personalisht në zyrat e LAB-it e cila gjendet në Rr. "Adem Jashari" nr. 218 - Hani i Elezit.

Aplikacionet për linjën buxhetore 1 dorëzohen direkt në zyrat tona, ndersa për linjat buxhetore 2 dhe 3 mund të dërgohen edhe përmes e-mailit në adresën hysen.shabanaj@lab-ks.org ose të dorëzohen direkt në zyrat tona, duke filluar nga data e publikimit të thirrjes.

Vetëm aplikacionet e kompletuara, të dërguara përmes e-mailit të lartëcekur ose të dorëzuara direkt në zyrat tona brenda afatit për aplikim, do të konsiderohen për vlerësim.

Afatet

Aplikacionet e kompletuara me dëshmitë, anexet e bashkangjitura, mund të dorëzohen duke filluar nga data e publikimit të thirrjes deri me datë **25/08/2023**.

Konfirmimi i pranimit të aplikacionit bëhet më së largu tri ditë pas pranimit të aplikimit përmes e-mailit ose menjëherë pas dorëzimit të kërkesës në zyrat tona. Nëse një konfirmim i tillë nuk është marrë në këto afate kohore, ju lutem na kontaktoni duke na shkruar në adresën tonë të e-mailit ose përmes telefonit +383 290 385 500 lokali 1120.

Kandidatët do të informohen për rezultatet e vlerësimit me e-mail, përmes publikimit të listës së përfituesve në web faqen e LAB – it dhe në tabelen e shpalljeve publike në objektin e Komunës së Hanit të Elezit.

Nëse keni ndonjë pyetje shtesë në lidhje me thirrjen, ju lutem na kontaktoni përmes e-mailit në adresën hysen.shabanaj@lab-ks.org